

**Republika e Maqedonisë së Veriut**  
**GJYKATA THEMELORE CIVILE SHKUP**

**02-Su.nr.59/19**

**26.07.2019**

**S h k u p**

Në bazë të nen.36 nga Ligji për shërbim gjyqësor („Gazeta Zyrtare e RM“ nr.43/14, 33/15, 98/15, 6/16, 198/18 dhe 248/18) dhe Propozimit të Komisionit për Selektim të punësimeve për vendin e punës numër 1- Administrator gjyqësor, Kategoria A, niveli A-2, nën 07-Su.nr.669/19-13 e datës 25.07.2019, UD Kryetari i Gjykatës Themelore Civile Shkup, më datë 26.07.2019, solli:

**VENDIM PËR ZGJEDHJE PËR PUNËSIM**

Për vendin e punës numër 1 - Administrator gjyqësor, Kategoria A, niveli A-2 zgjidhet kandidati:

**- Hristina Palçevska.**

**Arsyetim**

Gjykata Themelore Civile Shkup, më datë 21.06.2019, publikoi shpallje publike nr.2/2019 për punësim të një (1) realizuesve në vendin e punës Administrator gjyqësor, Kategoria A, niveli A-2, në gazetata ditore „Nova Makedonija“ dhe „Lajm“, si dhe në internet faqen e gjykatës.

Pas zbatimit të procedurës për selektim të punësimit për vendin e punës numër 1- Administrator gjyqësor, Kategoria A, niveli A-2, në pajtim me Ligjin për shërbim gjyqësor dhe Rregullores për formën dhe përmbajtjen e shpalljes publike, formës, përmbajtjes dhe mënyrës së parashtrimit të fletëparaqitjes, të zbatimit të selektimit administrativ, të provimeve, kontrollimit të besueshmërisë së dëshmimeve dhe intervistës, si dhe mënyrës së bodimit dhe numrit maksimal të poenave nga procedura e selektimit në varshmëri nga kategoritë të vendeve të punës, si dhe çështje tjera në procedurën për punësim të nëpunësve gjyqësor („Gazeta Zyrtare e RM“ nr.236/18), Komisioni për selektim të punësimeve për vendin e punës numër 1 - Administrator gjyqësor, Kategoria A, niveli A-2 gjer

tek U.D.Kryetari i Gjykatës dorëzoi propozim të kandidatë përpunësim për vendin e punës numër 1 - Administrator gjyqësor, Kategoria A, niveli A-2, të evidentuar nën 07-Su.nr.669/19-13 e datës 25.07.2019.

Në pajtim me Propozimin e shënuar, për vendin e punës numër 1 - Administrator gjyqësor, Kategoria A, niveli A-2, propozohet kandidati Hristina Palçevska.

Në pajtim me nenin.36 parag 1 nga Ligji për shërbimin gjyqësor, administratori gjyqësor, gjegjësisht Kryetari i gjykatës në të cilin nuk është i zgjedhur administrator gjyqësor, në afat prej pesëditësh pas marrjes së propozimit të kandidatëve për punësim, është i detyruar të sjellë vendim për zgjedhje.

Duke u udhëhequr nga zbatimi i dispozitës ligjore, ndërsa duke e pasur parasysh Propozimin e kandidatë për punësim në vendin e punës numër 1 - Administrator gjyqësor, Kategoria A, niveli A-2, të evidentuar nën 07-Su.nr.669/19-13 e datës 25.07.2019, U.D Kryetari i Gjykatës vendosi si në thënien.

**GJYKATA THEMELORE CIVILE SHKUP  
U.D KRYETAR,  
ILIR SULEJMANI**

**DZ:**

- Hristina Palçevska
- administrata gjyqësore
- në internet faqen e gjykatës
- në tabelën e shpalljeve të gjykatës